



Drejt një qeverisjeje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkufitare të rajonit të Liqenit të Ohrit

MBROJTJA E

RAJONIT TË LIQENIT TË OHRIT

PËRGJEGJËSITË DHE PËRFITIMET TONA TË PËRBASHKËTA

Ky botim është mundësuar falë asistencës së Bashkimit Europian. Përmbajtja e këtij botimi është në përgjegjësinë e vetme të UNESCO-s dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si pasqyrim i pikëpamjeve të Bashkimit Europian.



MBROJTJA E RAJONIT TË LIQENIT TË OHRIT- PËRGJEGJËSITË DHE PËRFITIMET TONA TË PËRBASHKËTA

Rajoni ndërkuftar i Liqenit të Ohrit

Në rajonin e Liqenit të Ohrit, disa nga vendbanimet më të hershme në Evropë dhe itinerarët e trashëgimisë rrethojnë një nga liqenet më të vjetra të Evropës. Në këtë vend të veçantë, historia e natyrës dhe kulturës janë ndërthurur së bashku për të krijuar një trashëgimi të jashtëzakonshme që prej kohësh ka kapërcyer kufijtë dhe që duhet të vazhdoi në këtë rrjedhë në shërbim të brezave që do të vijnë.

Liqeni i Ohrit ndodhet midis Shqipërisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, ndërsa ligatinat e tij shtrihen deri në Liqenin e Prespës. Për këtë arsye përpjekjet e bashkëkoordinuara midis dy vendeve janë të domosdoshme për të siguruar mbrojtjen e trashëgimisë së pasur të rajonit të Liqenit të Ohrit.

Mbrojtja e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore e rajonit të Liqenit të Ohrit

Në Shqipëri janë përcaktuar disa zona të mbrojtura në nivel kombëtar, si Peizazhi i Mbrojtur Ujor dhe Tokësor i Pogradecit, Driloni - Monument Kombëtar dhe në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë Liqeni i Ohrit Monument Natyre si dhe Parku Kombëtar i Galicias.


Mbrojtja e territorit është përforcuar më tej me regjistrimin në Listën e Trashëgimisë Botërore të pjesës maqedonase të rajonit në vitin 1979, dhe krijimin e Rezervës ndërkuftare të Biosferës së Liqeneve Ohër-Prespë (Shqipëri/ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë).



Sfidat

Pavarësisht masave mbrojtëse në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar, zhvillimi urban i paplanifikuar, keqmenaxhimi i ujërave dhe i mbetjeve të ngurta, prishja e habitateve, shkatërrimi dhe shterrimi i burimeve natyrore, minierat, zhvillimi i infrastrukturës dhe turizmit masiv, janë një kërcënim i vazhdueshëm për trashëgiminë e rajonit.

I përgatitur për të mbështetur të dy vendet në përpjekjet e tyre për të mbrojtur zonën, projekti “Drejt një qeverisjeje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkufitare të rajonit të Liqenit të Ohrit”, përqendrohet, si në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ashtu dhe në atë të natyrës, duke vënë në dukje vlerat e tyre të shumta e trajtimin e kërcënimeve kryesore me të cilat ato përballen, përmes një qasjeje të zhvillimit të qëndrueshëm.



Pasuri e Trashëgimisë Botërore

Pasuria Trashëgimi Botërore “Trashëgimia Natyrore dhe Kulturore e rajonit të Ohrit” u regjistrua në Listën e Trashëgimisë Botërore në vitin 1979, fillimisht si pasuri natyrore, dhe një vit më vonë si pasuri (natyrore dhe kulturore) në bazë të kriterëve të Trashëgimisë Botërore (I), (iii), (iv), dhe (vii).

Kriteret e Pëzgjdhjes si Trashëgimi Botërore

- **Kriteri (i):** përfaqëson një kryevepër të gjenialitetit krijues të njeriut;
- **Kriteri (iii):** bart një dëshmi unikale ose të paktën të jashtëzakonshme për një traditë kulturore apo qytetërim që jeton ose është zhdukur;
- **Kriteri (iv):** përfaqëson një shembull të pakrahasueshëm të një tipi ndërtimi, ansambli arkitektonik apo teknologjik apo peizazhi, i cili dëshmon (një) etapë të rëndësishme në historinë e njerëzimit; dhe
- **Kriteri (viii):** përmban një fenomen të rrallë natyror ose zona me bukuri të jashtëzakonshme natyrore dhe rëndësi estetike.

Pasuria e regjistruar përfshin Qendrën Historike të Ohrit, qytetin e Strugës, disa vendbanime peshkatarësh përgjatë bregut, qendrat e hershme shpirtërore të krishtera dhe manastiret, si dhe mbi 250 qendra arkeologjike që mbulojnë një periudhë prej më shumë se 5,000 vjeçare.

Qyteti i Ohrit, një nga vendbanimet më të vjetra të njeriut në Europë, përfaqëson një mjedis të rrallë arkitektonik dhe artistik dhe krenohet me pasurinë e vlerave arkitektonike, arkeologjike, materiale dhe shpirtërore. Qendra urbane e Ohrit përfshin ndërtime dhe tipare të tjera që datojnë në periudhat e prehistorisë, Antikitetit dhe Antikitetit të Vonë, Krishtëritit të Hershëm, Mesjetës së Hershme dhe të Vonë dhe periudhës Osmane, deri në ditët e sotme.

Liqeni i Ohrit prej kohësh njihet si një fenomen natyror i jashtëzakonshëm. Me më tepër se një milion vjet histori gjeologjike dhe biologjike, Liqeni i Ohrit përfaqëson një nga liqenet më të vjetra në Evropë dhe një zonë me biodiversitet të larmishëm me rëndësi globale. Është vlerësuar si liqeni me biodiversitetin më të lartë në botë, duke marrë parasysh numrin e llojeve endemike për sipërfaqe. Po ashtu, edhe ligatinat e liqenit të Ohrit kanë një biodiversitet po kaq të pasur dhe të rëndësishëm, me një numër jashtëzakonisht të lartë të specieve endemike.

Projekti i përbashkët i BE-UNESCO-s

Projekti “Drejt një qeverisjeje të përbashkët të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ndërkufitare të rajonit të Liqenit të Ohrit” synon profilizimin e zonës ndërkufitare, duke vënë në dukje vlerat dhe mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm, si dhe ngritje të kapaciteteve për një menaxhim efektiv të trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Projekti gjithashtu mbështet një proces gjithëpërfshirës për planifikimin e menaxhimit të integruar dhe përgatitjen e dokumentacionit nga ana e autoriteteve shqiptare, për të zgjeruar pasurinë e Trashëgimisë Botërore edhe në pjesën shqiptare të rajonit të Liqenit të Ohrit.

Kontributi i Bashkimit Evropian prej 1.7 milion EUR, për projektin është dhënë në kuadër të ndihmës ndaj vendeve të përfshira në proces antarësimi në fushën e Mjedisit dhe Ndryshimeve Klimaterike. Edhe Qeveria e Shqipërisë ka dhënë kontributin e saj në vlerën prej 170,000 EUR. Buxheti përgjithshëm i këtij projekti tre vjeçar vlerësohet në rreth 1.87 milion EUR.

Duam të punojmë së bashku për rajonin e Liqenit të Ohrit!



KUSH ËSHTË I PËRFSHIRË?

Koordinator projekti - UNESCO, Qendra për Trashëgiminë Botërore

Themeluar në vitin 1992, Qendra për Trashëgiminë Botërore e UNESCOs promovon dhe koordinon zbatimin e Konventës së Trashëgimisë Botërore të vitit 1972. Qendra organizon takime vjetore të Komitetit të Trashëgimisë Botërore dhe së bashku me organet këshilluese IUCN, ICCROM dhe ICOMOS, asiston Shtetet Palë në përgatitjen e nominimeve

Bashkimi European – donatori kryesor

Bashkimi European përbëhet nga 28 Shtete Anëtare të cilët vendosën që gradualisht të lidhin njohuritë e tyre, burimet dhe fatet. Së bashku gjatë 60 viteve të sgrjerimit, kanë ngritur një zonë stabiliteti, demokracie dhe zhvillimi të

Partnerë te projektit

Ministria e Mjedisit e Republikës së Shqipërisë ka si mision zhvillimin dhe propozimin e politikave, strategjive dhe planeve te veprimit për mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e cilësisë së jetës si dhe promovimin drejt integritit në Bashkimin European. Ky mision realizohet duke marrë pjesë, nxitur dhe koordinuar aktivitetet për zhvillimin afatgjatë, mbrojtjen e burimeve natyrore dhe ndërgjegjesimin e popullatës.

Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë është përgjegjëse për zbatimin e politikave kulturore të qeverisë. Një rrjet prej 29 institucionesh shtetërore në varësi të Ministrisë, zbaton dhe mbështet projektet, programet dhe aktivitetet që lidhen me ruajtjen, restaurimin, administrimin, vlerësimin dhe promovimin e kulturës dhe trashëgimisë kulturore në Shqipëri.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë është përgjegjëse për zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe ligjeve që lidhen me mjedisin dhe mbrojtjen e natyrës. Ministria është e përfaqësuar në Komisionin Kombëtar për UNESCO-n, Komisionin e Menaxhimit për Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore të rajonit të Ohrit, si dhe në Komitetin ndërkufitar të pellgut te Liqenit te Ohrit, i themeluar në bazë të marrëveshjes midis Qeverisë së Shqipërisë dhe IRJ të Maqedonisë për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të liqenit të Ohrit dhe të pellgut të tij ujëmbledhës.

Ministria e Kulturës - Zyra për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore (ZMTK) është themeluar me ligj në vitin 2004, si një organ i pavarur qeveritar administrativ dhe pjesë

në Listën e Trashëgimisë Botërore, koordinon raportimin për gjendjen e konservimit të pasurisë Trashëgimi Botërore dhe organizon ndërhyrjen emergjente dhe asistencën ndërkombëtare nga Fondi i Trashëgimisë Botërore në rast se një pasuri trashëgimi botërore kërcënohet.

qëndrueshëm duke ruajtur diversitetin kulturor, tolerancën dhe lirinë e tyre. Bashkimi European është i angazhuar që arritjet dhe vlerat e tij t'ndajë me vëndet përtej kufijve.

përbërëse e Ministrisë së Kulturës së IRJ të Maqedonisë. ZMTK kryen veprimtari administrative, profesionale dhe të tjera të lidhura me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore sipas Ligjit për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore. Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore në rajonin e Ohrit është nën përgjegjësinë e Institutit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe Muzeut - Ohër.

ICCROM (Qendra Ndërkombëtare për Studimin e Ruajtjes dhe Restaurimit të Pasurisë Kulturore) është një organizatë ndërkombëtare ndërqeveritare me seli në Romë, Itali. Krijuar nga UNESCO në vitin 1956, funksionet statutores të ICCROM janë kërkimi, dokumententimi, asistenca teknike, trajnimi dhe programe për ndërgjegjësimin e publikut për të forcuar ruajtjen e trashëgimisë kulturore të paluajtshme dhe të luajtshme.

ICOMOS (Këshilli Ndërkombëtar për Monumentet dhe Sitet) është një organizatë jo-qeveritare me seli në Paris, Francë. E themeluar në vitin 1965, roli i saj është që të promovojë zbatimin e teorisë, metodologjinë dhe teknikat shkencore për ruajtjen e trashëgimisë arkitekturore dhe arkeologjike.

IUCN (Bashkimi Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës) është themeluar në vitin 1948 dhe bashkon qeveritë kombëtare, OJQ-të, dhe shkencëtarët në një partneritet mbarë botëror. Misioni i saj është të ndikojë, inkurajojë dhe ndihmojë shoqëritë në të gjithë botën për të ruajtur integritetin dhe diversitetin e natyrës dhe për të siguruar që çdo përdorim i burimeve natyrore të jetë i drejtë dhe ekologjikisht i qëndrueshëm. IUCN ka selinë e saj në Gland, Zvicër.



TË DHËNA SHIFRORE TE LIQENIT TË OHRIT

Rajoni i Liqenit të Ohrit

- Ndodhet 683 m mbi nivelin e detit.
- Kufizohet nga vargmale të larta në lindje dhe perëndim, që arrijnë rreth 2,250 m mbi nivelin e detit.
- Thellësia maksimale është rreth 288.7 m dhe thellësia mesatare 155 m.
- Është një nga liqenet më të mëdhenj në Evropë.
- Sipërfaqja 358 km², prej të cilave afërsisht dy të tretat janë në IRJ të Maqedonisë dhe rreth një e treta në Republikën e Shqipërisë.
- Ligatinat janë prej 1,129 km², por burimi efektiv shtrihet në basenin e Liqenit të Prespës nga një lidhje karstike nëntokësore.
- Mbi 1,400 specie vendase, përfshirë rreth 300 specie endemike të liqenit të Ohrit.
- Mbi 160,000 njerëz jetojnë rreth liqenit të Ohrit, ku pothuajse 52,000 në Shqipëri (nga të dhënat e vitit 2011).
- Rreth 300,000 turistë vizitojnë trashëgiminë natyrore dhe kulturore të rajonit çdo vit.

Për më shumë informacion: <http://whc.unesco.org/en/lake-ohrid-region/>

Foto të: Avramoski Oliver, Dieterich Til, Erg Boris, Graz Christophe, Levkov Zlatko, Matevski Vlado



Shtypur në letër të ricikluar.